

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

“ENERGY GREEN” sh.p.k

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, me vullnetin e saj të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë 21/02/2025, Themeluesit:

Dritar Harapi, atësia Frederik, amësia Mediha, shtetas shqiptar, lindur në Tirane, ne 24.04.1967 dhe banues në Tirane , me adresë Rruga : Karl Topia 1001 ", gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i dokumentit të identifikimit ID 038231798 leshuar nga shteti Shqiptar ne date 22.04.2022 dhe date skadimi 21.04.2032, me nr personal G70424226M.

Blond HANI, atësia Alfons, amësia Anila, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane, ne 15.09.1998 dhe banues në Tirane, me adresë Njesia Nr 2, Rruga e Elbasanit, Pallati Teuta, nr 10, prapa Shkolles se Mesme Asim Vokshi Tiranë, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i dokumentit të identifikimit ID Nr.033481531 dhe Nr personal J80915082H leshuar nga shteti Shqiptar ne date 05.09.2017 dhe date skadimi 04.09.2027

Deklarojn se kanë vendosor të nënshkruajne këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë refereruar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

Neni 1-Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është

“ENERGY GREEN” sh.p.k

Emri tregtar i shoqërisë: “ENERGY GREEN” SHPK

Në të gjitha aktet dhe dokumentat që dalin nga shoqëria, emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëherë) nga inicialet “SH.P.K”.



Neni 2-Vëndndodhja e selisë

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet: Tiranë, Njesia Nr 2, Rruga e Elbasanit, Pallati Teuta, nr 10, prapa Shkolles se Mesme Asim Vokshi.

Neni 3- Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Qendren Kombetare te Rregjistrimi.

Neni 4- Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

- 1.Financimi, blerja dhe shitja e centraleve te prodhimit te energjise nga panelet fotovoltaike, eolike dhe hidrike. .Projektimi i centraleve te prodhimit te energjiise nga panelet fotovoltaike, eolike dhe hidrike .**
- 2. Ndertim-Montim dhe venia ne pune e centraleve te prodhimit te energjise nga panelet fotovoltaike, eolike dhe hidrike.**
- 3. Prodhim, transport dhe shitjen e energjise nga centralet me panelet fotovoltaike, eolike dhe hidrike.**
- 4. Mirembajtja e centraleve te prodhimit te energjise nga panelet fotovoltaike, eolike dhe hidrike dhe paisjesh dhe sistemesh teknologjike per prodhimin e energjiise.**
- 5. Trainim personeli per administrimin, mirembajtjen dhe sherbimin e centraleve, paisjeve dhe sistemeve teknologjike per prodhimin e energjiise nga panelet fotovoltaike, eolike dhe hidrike.**
- 6.Per me teper Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji ne fuqi, qe sjell perfitime dhe eshte ne interes te Shoqerise.**
- 7.Shoqeria mund te kryeje edhe aktivitete te tjera shtese, me qellim permbushjen e veprimtarise se saj kryesore ne perputhje me legjisiacionin shqiptar ne fuqi.**
- 8.Cdo aktivitet tjeter tregtar qe lidhet ne menyre te drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e veprimtarise dhe qe eshte ne perputhje me legjisilacionin ne fuqi.**

Neni 5- Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërise është 10'000 (dhjete mije) lekë.

Kapitali themeltar është i perbërë nga 2 (dy) pjesë kapitali me vlerë nominale seicili nga 5'000 (pese mije) lekë.



Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10'000 (dhjete mije) lekë.

Kapitali themeltar është i përbërë nga 2 (dy) pjesë kapitali me vlerë nominale secili nga 5'000 (pese mije) lekë.

Sipas kontributeve në kapitalin themeltar të shoqërisë pjesët e tij ndahen:

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakët e shoqërisë përkatësisht:

Z. Dritar Harapi, shtetas shqiptar, lindur në Tirane, ne 24.04.1967 dhe banues në Tirane , me adresë Rruga : Karl Topia 1001 ", mbajtes i dokumentit te identifikimit ID me nr personal G70424226M, vlera e kapitalit të përgjithshëm **5'000** Lekë, numri i pjeseve 1, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Z.Blond HANI, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane, ne 15.09.1998 dhe banues në Tirane, me adresë Njesia Nr 2, Rruga e Elbasanit, Pallati Teuta, nr 10, prapa Shkolles se Mesme Asim Vokshi Tiranë, mbajtes i dokumentit te identifikimit ID me nr personal J80915082H, vlera e kapitalit të përgjithshëm **5'000** Lekë, numri i pjeseve 1, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit te tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

Neni 8- Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose disa administratore, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.

Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.

Administratori i vetem i shoqërisë është : Z. Blond HANI, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane, ne 15.09.1998 dhe banues në Tirane, me adresë Njesia Nr 2, Rruga e Elbasanit, Pallati Teuta, nr 10, prapa Shkolles se Mesme Asim Vokshi Tiranë me afat 5-vjecar, deri më 20/02/2030 .

Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u përkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në regjistrin tregtar.

Neni 9- Të tjera

Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni - 10

Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpërdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni - 11

Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

Parë dhe miratuar në Tirane , më 21/02/2025.

ORTAKËT E SHOQËRISË

DRITAR HARAPI

BLOND HANI

DRITAR HARAPI


Blond Hani
